



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 367/1 prot.

Tiranë, më 02.03.2021

VENDIM
Nr.20, datë 02.03.2021

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 94, DATË 21.09.2020

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 94, datë 21.09.2020, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit nr. 99 (1634 prot.) datë 17.04.2020, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, për parregullsi të kryera në zhvillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm të nëpunësit ***** dhe masat për përmirësimin e gjendjes”.

KONSTATOVA SE:

Me anën e kërkesës së regjistruar me nr. 509 prot., datë 04.06.2020, nga nëpunësi janë parashtruar pretendimet e tij për parregullsi të kryera në zhvillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm (komandimit) të tij, e përmyllur me aktin administrativ nr. 99 (nr. 1634 prot.), datë 17.04.2020, “Për komandimin e nëpunësit civil *****”, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni i Bashkisë Tropojë të dërgojë gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me procesin e transferimit të përkohshëm të nëpunësit.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 94, datë 21.09.2020, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit nr. 99 (1634 prot.) datë 17.04.2020, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, për parregullsi të kryera në zhvillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm të nëpunësit ***** dhe masat për përmirësimin e gjendjes”.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Tropojë në rrugë elektronike, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin dhe në pjesën arsyetuese të vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 94, datë 21.09.2020, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga ana e organit publik, Kryetari i Bashkisë Tropojë, që bazuar në nenin 113, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, me një akt të ri me shkrim, të anulojë aktin administrativ nr. 99 (1634 prot.), datë 17.04.2020, “Për komandimin e nëpunësit civil *****”, si një akt i paligjshëm, duke kthyer gjithçka në gjendjen e mëparshme.

Konkretisht, me Urdhrin nr. 99/1, datë 28.9.2020, është rikthyer gjendja e ligjshmërisë nga ana e Kryetarit të Bashkisë Tropojë, duke zbatuar detyrën e lënë nga ana e Komisionerit

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 94, datë 21.09.2020, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit nr. 99 (1634 prot.) datë 17.04.2020, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, për parregullsi të kryera në zhvillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm të nëpunësit ***** dhe masat për përmirësimin e gjendjes”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Tropojë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 94, datë 21.09.2020.

3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Tropojë dhe nëpunësi *****.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha